

VENDIM
Nr.976, datë 2.7.2008

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS SHQIPTARE, PJESËMARRËSE
NË OPERACIONIN USHTARAK “EUFOR TCHAD/RCA”, TË BASHKIMIT
EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të aktit normativ nr.3, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një kompanie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në operacionin “EUFOR TCHAD/RCA”, të Bashkimit Europian”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, brenda fondeve buxhetore, vjetore, të përballojë shpenzimet, në mbështetje të forcave shqiptare, pjesëmarrëse në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore (operacioni “EUFOR TCHAD/RCA”), si shpenzime të drejtpërdrejta kombëtare, për:

- a) evakuim mjekësor strategjik;
- b) ndërlidhje strategjike;
- c) shërbim postar dhe veprimtari të tjera zyrtare.

2. Efektet financiare, në vlerën 7 920 000 (shtatë milionë e nëntëqind e njëzet mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha